

**PROPOZIM - ORË PËR REALIZIMIN E
PËRMBAJTJEVE NGA FUSHA**


EDUKIMI

MEDIATIK

DHE KULTURA

MEDIATIKE

KLASA V



EDUKIMI

MEDIATIK

DHE KULTURA

MEDIATIKE

NË MËSIMIN

KLASOR



EDUKIMI MEDIATIK DHE KULTURA MEDIATIKE NË MËSIMIN KLASOR

- Doracak për mësimdhënës për klasën e V-të -

Botues: Instituti Maqedonas për Media
rr. "Jurij Gagarin", 17/1-1
1000 Shkup

Byroja për Zhvillim të Arsimit
rr. "Rugjer Boshkoviç", nr.20
1000 Shkup

Redaktorë: Mitko Çashllarov
Ajshe Ajrullai

Autorë: Marina Dimitrieva – Gjorgjievska
Olivera Todoroska
Mitko Çashllarov
Ajshe Ajrullai

Redaksia profesionale: Mihajlo Llahtov
Vesna Nikodonoska

**Përkthimi dhe lektura në
gjuhën shqipe:** Vjosa Taipi

Dizajni dhe përpunimi teknik: Koma dizajn

Doracaku është punuar në kuadër të Projektit të USAID për edukim mediatik "Të rinjtë mendojnë", të cilin e realizojnë IREX dhe partnerët lokalë Instituti Maqedonas për Media, Instituti për Studime të Komunikimit dhe Forumi Arsimit Rinor, në bashkëpunim me Byronë për Zhvillim të Arsimit dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Përkrahja për përpilimin e Doracakut është siguruar nga populli amerikan nëpërmjet Agjencisë së SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përbajtja e Doracakut është përgjegjësi e IREX dhe e Institutit Maqedonas për Media (IMM) dhe nuk l reflekton qëndrimet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



Hyrje

Sot, në kohën e një “realiteti të ri mediatic”, kur të rinjtë janë të ekspozuar ndaj një sasive të madhe informacioni në baza ditore, përmes platformave dhe teknologjive mediatike tradicionale dhe veçanërisht digjitale, është e nevojshme, përmes arsimit, në shkollë, të fitohen njohuri dhe aftësi për rishqyrtimin kritik të përmbajtjeve mediatike. Është e nevojshme që nxënësit të jenë në gjendje të dallojnë “kryesoren dhe dytësoren” në gjithçka që lexojnë, dëgjojnë ose shohin, të njohin elementet e propagandës ose mesazheve të fshehura reklamuese, të njohin gjuhën e urrejtjes implicite dhe eksplicite. Përmes mësimdhënies, nxënësit duhet të aftësohen të përdorin në mënyrë efektive informacionet, përmbajtjet dhe platformat mediatike, ndërkaq përmes pjesëmarrjes së tyre aktive në media të ndryshme sociale, pritet që ata të veprojnë me përgjegjësi dhe në mënyrë kritike të qasën përmbajtjes që “krijojnë”.

Në këtë drejtim, edukimi mediatic futet në planet dhe programet e reja me rezultate të caktuara të të nxënësve, përmbajtje, standarde për vlerësim dhe shembuj të aktiviteteve me të cilat nxënësit do të kenë qasje më të përgjegjshme në media, do të analizojnë mesazhet dhe do të vlerësojnë informacionet në të cilat kanë qasje, do të përdorin informacionet që pranojnë përmes mediave dhe vetë do të krijojnë mesazhe mediatike në një mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme.

Në programet mësimore nga klasa e parë deri në klasën e pestë të arsimit fillor, mësimi i edukimit mediatic është i integruar në një numër përmbajtjesh dhe aktiviteteve në lëndë të ndryshme mësimore. Kështu, në kuadër të programit mësimor në lëndët gjuha maqedonase, gjuha shqipe, gjuha turke, gjuha serbe dhe gjuha boshnjake, është zhvilluar një fushë e veçantë e titulluar *Edukimi mediatic dhe kultura mediatike*.

Për arritjen e suksesshme të rezultateve nga të nxënësve, të përcaktuara në këtë fushë të programit mësimor, është e nevojshme të realizohen aktivitete cilësore dhe krijuese gjatë orëve mësimore, përmes të cilave nxënësit do “të edukohen” dhe do të mësojnë për mediat dhe rolin e tyre.

Doracaku për mësimdhënësit që realizojnë mësim në lëndët gjuha maqedonase, gjuha shqipe, gjuha turke, gjuha serbe dhe gjuha boshnjake do tu ndihmojë mësimdhënësve të grupit klasor dhe lëndor gjatë planifikimit dhe realizimit të orëve mësimore, gjatë së cilave përpunohen përmbajtjet për edukim mediatic dhe kulturë mediatike. Doracaku është përgatitur të jetë një mbështetje dhe frymëzim në punën e mësimdhënësve për realizim të suksesshëm dhe realizim kreativ të mësimdhënies.

Çdo shembull për realizimin e aktiviteteve të orëve mësimore i referohet përmbajtjes specifike që lidhet me standardet përkatëse për vlerësim nga programi mësimor që duhet të arrihet përmes aktiviteteve gjatë prës mësimore. Gjithashtu janë shënuar edhe pajisjet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve gjatë orës mësimore.

Shembujt e orëve janë zhvilluar përmes aktiviteteve për pjesën hyrëse, për pjesën kryesore dhe për pjesën përfundimtare të orës. Qëllimi i aktiviteteve hyrëse është të aktivizojë para njohuritë e nxënësve dhe t'i prezantojë ata me përmbajtjen. Zakonisht konceptohen përmes hulumtimeve ose diskutimeve të shkurta për të shpjeguar ose "paralajmëruar" konceptet që do të përpunohen gjatë orës. Në pjesën që ka të bëjë me aktivitetet nga pjesa kryesore e orës mësimore, jepet një përshkrim i detajuar i aktivitetit/aktiviteteve përmes të cilave nxënësit do të eksplorojnë dhe mësojnë përmes përvojës, si dhe një propozim për mënyrën e organizimit të punës së nxënësve në grupe ose në çifte. Aktivitetet kryesore për orët mësimore në Doracak, ofrojnë një gamë të gjerë idesh për mësim dhe për veprim krijues. Aktivitetet përfundimtare, nga ana tjetër, kanë për qëllim nxjerrjen e konkluzioneve përmes diskutimeve. Pjesa e fundit e shembujve për orët mësimore, paraqet reflektim në të cilin ofrohen pyetje në lidhje me atë që nxënësit kanë mësuar, duke përmbledhur dhe lidhur atë që kanë mësuar me jetën e tyre të përditshme.

Mësimdhënësit mund t'i përdorin shembujt për realizimin e orëve për edukim mediatik nga doracaku si ide për aktivitete përmes të cilave do të arrijnë standardet për vlerësim në realizimin e përmbajtjes së mësipërme të programi mësimor për gjuhë maqedonase, shqipe, turke, serbe dhe boshnjake. Aktivitetet mund të ndërmerren siç janë dhënë, mund të përshtaten ose modifikohen, përkatësisht të ndryshohen në përputhje me idetë e mësuesit, nevojat dhe interesat e nxënësve dhe përparimin e tyre në procesin mësimor, mjetet e punës në dispozicion, kushtet në shkollë, etj. Ato paraqesin shembuj të të mësuarit kreativ dhe eksperimental për edukim mediatik sipas programeve mësimore të reja. Bazuar në këto shembuj, mësuesit mund të zhvillojnë lehtësisht skenarë për realizimin e orëve mësimore, në varësi të mjedisit dhe kushteve në të cilat ata realizojnë mësimin. Përveç kësaj, mësimdhënia e integruar mundëson që disa nga standardet dhe aktivitetet për arritjen e tyre të lidhen me përmbajtje të ngjashme ose të përafërta, që janë parashikuar në lëndë të tjera.

Pritet që ky manual të jetë jo vetëm një mbështetje për mësuesit në planifikimin dhe zbatimin e mësimdhënies, por gjithashtu të jetë një nxitje për kreativitet, motivim dhe entuziazëm edhe më të madh gjatë punës.

Udhëzim për mësimdhënësin/mësimdhënësen për shfrytëzimin e Doracakut për Edukim Mediatik për klasën V

Më shumë informacione për termat e rinj dhe konceptet thelbësore, mësimdhënësi mund të lexojë në *Fjalorin e fushës së edukimit mediatik*, që është pjesë e këtij doracaku. Në këtë mënyrë, mësimdhënësi do të mund t'i aftësojë përmbajtjet sipas moshës së nxënësve dhe më lehtë mund t'ua transmetojë, me qëllim që ata t'i kuptojnë.

KLASA E V-të

EDUKIMI MEDIATIK DHE KULTURA MEDIATIKE

Sipas planit mësimor për lëndën e gjuhës maqedonase për klasën e pestë, në fushën e edukimit mediatic dhe kulturës mediaticke mësohen këto:

Përmbajtje (dhe nocione)

- Media tradicionale dhe mediat digjitale
- Mediat sociale
- Fakte dhe opinione (informacion, lajm, intervistë, informacion i rremë/dezinformatë)

Në fund të vitit shkollor nxënësit në këtë fushë, duhet të arrijnë këto:

Rezultate nga mësimi

Nxënësi/nxënësja duhet të jetë i/ e aftë të:

1. dallojë mediat tradicionale dhe digjitale dhe shpjegojnë përparësitë dhe mangësitë e tyre;
2. të dallojë faktet dhe opinionet në përmbajtjet mediaticke dhe të krijojë përmbajtje mediaticke duke përdorur fakte dhe opinione;
3. të përdorë mënyra të thjeshta për të verifikuar informacionin dhe fotografitë nga interneti.

Nxënësi/ nxënësja do të zhvillojë vetëdijen për:

1. pasojat e përdorimit të tepruar të rrjeteve sociale;
2. nevojën për të verifikuar vërtetësinë e informacionit në internet dhe rrjetet sociale.

Lista e nocioneve në fushën e Edukimit Mediatik¹

Edukim mediatik ↘ Aftësia për të hyrë, analizuar, vlerësuar dhe krijuar përmbajtje mediatike, si dhe për të marrë pjesë në sferën publike përmes përdorimit të mediave në kontekste të ndryshme. Edukimi mediatik synon të ndihmojë qytetarët të njohin se si media filtron perceptimet dhe bindjet e tyre, si formon kulturën popullore dhe si ndikon në zgjedhjet personale. Përveç kësaj, edukimi mediatik i udhëzon qytetarët drejt të menduarit kritik dhe zgjidhjes krijuese të problemeve, duke i aftësuar të bëhen përdorues të kujdesshëm dhe krijues të informacioneve.

Edukimi mediatik fitoi rëndësi në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar me rritjen e medias. UNESCO në vitet 1960 mbështeti idenë e edukimit mediatik dhe në vitin 1976 zhvilloi një model për edukimin mediatik. Me rëndësi të veçantë është miratimi i Deklaratës për edukim mediatik, e vitit 1982 (nënshkruar nga 19 vende), përmbajtja e së cilës ndikoi në “hyrjen dhe zhvillimin” e edukimit mediatik në sistemin arsimor në shumë vende.

Në vitin 2011, kryesisht si rezultat i zhvillimit dinamik dhe të përshpejtuar të teknologjive të komunikimit dhe mjedisit mediatik, UNESCO plotësoi konceptin e edukimit mediatik me “edukim informativ” (media and information literacy)

Radio ↘ Mënyra e transmetimit pa tel (të tingujve dhe shenjave) në një distancë të gjatë me ndihmën e valëve elektromagnetike të dërguara përmes pajisjeve të veçanta (radio stacionet). Radioja është një nga mediat më të vjetra. Ajo u shfaq në fillim të shekullit të 20-të, si rezultat i disa shpikjeve teknologjike që mundësuan përdorimin dhe përhapjen e saj. Radio ishte një medium veçanërisht popullor në vitet 1930, por pas ardhjes së televizionit popullariteti i saj ka rënë.²

Televizioni ↘ Transmetimi dhe pranimi i imazheve të lëvizshme, objekteve të palëvizshme dhe zërit përmes radio-elektronikës. Televizioni si një medium u shfaq në vitet 1920. Komponenti i saj më i rëndësishëm, i cili e dallon atë nga mediat e tjera tradicionale, është transmetimi i imazheve lëvizëse tek shikuesit. Është mediumi më kompleks tradicional për shkak të mundësisë së tij të kombinojë imazhe, tinguj dhe fjalë.³

Gazeta ↘ Botim periodik (ditor, javor, mujor) me shumë faqe, në të cilin publikohen materiale mbi ngjarjet aktuale politike, shoqërore dhe ngjarje të tjera. Format e para të gazetave datojnë që nga epoka romake, por shtypja dhe zhvillimi i gazetave moderne është i lidhur me krijimin e shtypshkronjës së Gutenberg-ut, në Gjermani në shekullin e 15-të.

1 Terma të shumfishtë të përfshirë në këtë Listë të nocioneve janë në përputhje me Fjalorin për Edukim mediatik të përgatitur nga Instituti i Studimeve të Komunikimit (2023), si dhe me “Doracakun për trajnerë për edukim mediatik: Mësojmë të njohim” të përgatitur në kuadër të Projektit të USAID-it për Edukimin Mediatik “Të rinjtë mendojnë”.

2 Todorovska-Pavlovska, S., Ivanov, Z. dhe Tanevski, Z. (2005) “Shkrim për mediat elektronike”, Shkup: Instituti Maqedonas për media.

3 Filkov, G. (2005) “Shkrim për mediat elektronike”, Shkup: Instituti Maqedonas për Media.

Mediat sociale ⇒ janë forma të komunikimit elektronik (si faqet e rrjeteve sociale dhe mikroblogging) përmes të cilave përdoruesit krijojnë komunitete online për të shkëmbyer informacion, ide, mesazhe personale dhe përmbajtje të tjera (video, audio, etj.). Përmbajtjet krijojnë me qëllim të shkëmbimit të informacioneve në lidhje me produktet, shërbimet, materialet, politikatat, lëvizjet, mendimet. Karakteristikat kryesore të mediave sociale janë shpejtësia, qasja dhe interaktiviteti.

Gazetar ⇒ person që në mënyrë profesionale mbledh dhe shkruan lajme dhe përmbajtje të tjera mediatike në media të shtypura, elektronike ose digjitale.

Redaksi ⇒ Zyrat ose ambientet e gazetës, radios, televizionit ose agjencisë së lajmeve ku mblidhen, shkruhen, redaktohen dhe prodhohen lajmet të cilat do të botohen në medium. Të gjithë të punësuarit në një medium.

Lajm ⇒ Informacion i ri në lidhje me një ngjarje, person ose situatë që transmetohet nëpërmjet mjeteve të informimit publik si gazeta, radio, televizioni ose online medium. Lajmi është një format specifik i përmbajtjes informative me titullin e vet, nëntitull dhe përmbajtje, të përgatitur nga gazetarë dhe redaktorë, dhe e publikuar përmes ndonjë lloji të medias.

Fakte dhe opinione – Opinioni është besim ose pikëpamje. Mundet, por nuk duhet të bazohet në fakte. Nuk mund të vërtetoni se mendimi juaj është i drejtë ose i gabuar.

Faktet, nga ana tjetër, mund të verifikohen dhe vërtetohen se janë të vërteta ose të pasakta. Faktet ndonjëherë mund të jenë të pavërteta. Vërtetësia e tyre mund të përcaktohet me ndihmën e provave.

Internet - Rrjet kompjuterik botëror që lejon përdoruesit e kompjuterëve personalë dhe pajisjeve të tjera informatike të vendosura kudo në Tokë të komunikojnë me njëri-tjetrin, të marrin dhe shkëmbejnë informacion tekst, audio dhe informacion vizual.

Digjitalizimi – mënyra në të cilën sferat e ndryshme të jetës sociale ristrukturohen që të adaptohen dhe përfshihen në komunikimin digjital dhe infrastrukturën mediatike.⁴

⁴ Bloomberg, J. „Digitization, digitalization and digital transformation: Confuse them at your peril”, Forbes.com, 29.04.2018. Në dispozicion në: [https://www.forbes.com/sites/jasonbloomberg/2018/04/29/digitization-digitalization-and-digital-transformation-confuse-them-at-your-](https://www.forbes.com/sites/jasonbloomberg/2018/04/29/digitization-digitalization-and-digital-transformation-confuse-them-at-your-peril/?sh=393feae2f2c7)

Siguria në Internet/Siguria online – Praktikata e ndjekjes së udhëzimeve, kuptimi i teknologjisë moderne dhe mbrojtja e pajisjeve digjitale me qëllim të mbrojtjes nga abuzime dhe ndikime të dëmshme në sferën online. Komunikimi dhe aktivitetet që zhvillohen duke përdorur teknologjitë digjitale mund të kërcënohen nga keqpërdorimi i identitetit, si dhe nga keqpërdorimi i të dhënave personale dhe financiare.

Të menduarit kritik krijues – Në kontekstin e sferës mediatike, paraqet një proces kompleks refleksiv të të menduarit, i cili përfshin perceptimin asociativ, sintezën, analizën dhe vlerësimin e mekanizmave të funksionimit të mediave në shoqëri dhe në tekstet mediatike (informacione/raporte), pasuar nga përfaqësimi audiovizual, eksperimentimi virtual, parashikimi logjik dhe intuitiv në sferën mediatike. Megjithatë, zhvillimi i të menduarit kritik nuk është qëllimi përfundimtar i edukimit mediatik, por një pjesë e përhershme e tij.

**PROPOZIM - ORË PËR REALIZIMIN E
PËRMBAJTJEVE NGA FUSHA**

E EDUKIMIT

MEDIATIK DHE

KULTURËS

MEDIATIKE




MEDIAT

TRADICIONALE

DHE DIGJITALE

(2 orë)



Ora 1

Histori e shkurtër e mediave

Standardi për vlerësim

Nxënësi/nxënësj:

- ↘ i përshkruan ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet mediave tradicionale dhe mediave digjitale.

Burimet për orën mësimore:

- ↘ disa telefona të mençur;
- ↘ qasje në internet;
- ↘ tabelë inteligjente/tabelë e zakonshme;
- ↘ karta me ilustrime;
- ↘ afishe ose fletë letre.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Çfarë janë mediumet? (realizimi 10 minuta)

Nxënësit, të ndarë në grupe, udhëzohen nga mësimdhënësi të hulumtojnë origjinën dhe kuptimin e fjalës “medium” përmes telefonave të tyre. Mësimdhënësi shkruan në tabelë disa pyetje, të cilave duhet tu përgjigjen përmes kërkimit:

- ↘ Nga cila gjuhë vjen fjala “medium”? Si përkthehet?
- ↘ Emërtoni disa kuptime të fjalës “medium”!

Pastaj, nxënësit në grupe diskutojnë dhe duhet të shkruajnë shembuj ku e kanë dëgjuar këtë fjalë në komunikimin e përditshëm.

Pas pesë minutash kërkimi dhe diskutimi në grup, një përfaqësues nga secili grup paraqet shpjegimet e gjetura dhe i shkruan në tabelë (ose në tabelën inteligjente).

Me ndihmën e mësimdhënësit, pas prezantimit të të gjitha grupeve, bëhet një “përmbledhje”:

Fjala “medium” vjen nga fjala latine “medius”, që përkthehet si “mes”, domethënë diçka që është “midis/ndërmjet”.

Në kuptimin komunikues të fjalës, media përfaqëson një ndërmjetës, përcjellës ose mjet, domethënë një kanal për transmetimin e informacionit në një audiencë të gjerë.

Sot, me fjalën medium/media nënkuptojmë televizionin, radion, gazetatat, revistat, librat, kinemanë, filmin, si dhe video lojërat, ueb portalet, mediat sociale dhe media të tjera që përdorin platforma digjitale për transmetimin dhe pranimin e informacioneve. Të gjitha këto media janë “ndërmjetës”, “mjete” që lejojnë transmetimin e informacioneve dhe mesazheve për një audiencë të madhe.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Rruga drejt Informacionit (realizimi 7-8 minuta)

Nxënësit, të ndarë në çifte, kanë për detyrë të imagjinojnë qytet ose vend në të cilin ndodhen, këtë ta shkruajnë në një letër ngjitesë dhe ta ngjisin në jakën e tyre të xhakëtës/bluzës. Pastaj, secili nxënës duhet të shpikë nga një fjali/mesazh, të cilën duhet ta shkëmbejë me nxënësin me të cilin janë çift. Mesazhi mund të jetë personal, ose mund të jetë lajm për ndonjë ngjarje. Pastaj, secili prej nxënësve tregon mesazhin, dhe në varësitë përmbajtjes së mesazhit, duhet të specifikojnë mediumin më të përshtatshëm për transmetimin e mesazhit (për shembull, “*Sot ndodhi një tërmet në Tiranë*” – lajm që mund të transmetohet përmes televizionit, ose “*E kalova provimin e fundit*” – mesazh personal që mund të transmetohet përmes SMS, e-mail, Viber, etj.). Pasi çiftet të kenë shkëmbyer “mesazhe” midis njëri-tjetrit, diskutimi mund të vazhdojë brenda klasës në drejtimin të asaj se forma dhe përmbajtja e informacionit varet, përkatësisht përshtatet me mediumin me të cilin transmetohet. Nxënësit citojnë shembuj të llojeve të ndryshme të mesazheve/lajmeve/informacioneve dhe diskutojnë se si, përkatësisht përmes cilit medium, ato mund të transmetohen.

Me ndihmën e mësimitdhënësit, bëhet përmbledhje se një ndërmjetës, kanal, medium është i nevojshëm që të mund të dërgohet përkatësisht pranohet informacion i caktuar.

2 Aktiviteti

Shiriti kohor (realizimi 10-15 minuta)

Nxënësit të ndarë në dy grupe marrin karta në të cilat janë shënuar lloje të ndryshme të mediave. Grupi i parë ka për detyrë të rendisë mediat në mënyrë kronologjike – nga paraqitja e mediumit më të vjetër deri në atë më modern (gazeta, radio, televizioni, televizioni kabllor, ueb portalet e gazetave, televizioni digjital, mediat sociale, siç janë Facebook, Twitter, Instagram, WhatsApp, TikTok, Snapchat, email dhe SMS). Grupi tjetër duhet të rendisë në mënyrë kronologjike shpikjet teknologjike në lidhje me mediat (shtypshkronjë, radio pranues, TV pranues, kompjuter, telefon, telefon inteligjent, tablet). Pastaj çdo grup prezanton punën që kanë bërë. Në fund të aktivitetit, mësuesi rregullon në mënyrë kronologjike llojet e mediave dhe shpikjet teknologjike që lidhen me to (Tabela 1 dhe Tabela 2) në tabelën inteligjente, ndërsa nxënësit kontrollojnë përgjigjet e tyre dhe korrigjojnë çdo gabim.

Tabela 1	
Gazeta	Shekulli i 16-17-të
Radio	Fillimi i shekullit të njëzetë
Televizion	Vitet e njëzeta të shekullit të njëzetë
TV kabllor	në fillim të viteve '80 të shekullit të 20-të
E-mail	Vitet e '70-ta të shekullit të njëzetë
Interneti i hershëm	1983
SMS	Vitet e '90-ta të shekullit të njëzetë
Google	1998
Facebook	2004
YouTube	2005
Twitter	2006
WhatsApp	2009
Snapchat	2011
TickTock	2016

Tabela 2	
Makinë printimi	Shekulli i 15-të
Radio pranues	fundi i shekullit të 19-të
TV pranues	Vitet e njëzeta të shekullit të njëzetë
Kompjuter	Vitet e '40-ta të shekullit të njëzetë
Internet	Vitet e '60-ta të shekullit të njëzetë
Telefon celular	Vitet e '80-ta të shekullit të njëzetë
Telefon i mençur	Fillimi i viteve '90 të shekullit të 20-të
Tablet	1987

Pas përfundimit të aktivitetit *Shiriti kohor* inkurajohet diskutim në lidhje me mënyrat në të cilat mediat kanë transmetuar informacionin me kalimin e kohës, për se kanë shërbyer dhe çfarë përparime teknologjike kanë sjellë në zhvillimin e mediave dhe transmetimin e informacionit.

Pjesa e fundit e orës mësimore

1 Aktiviteti


Fjala-fotografi (realizimi 5 minuta)

Nxënësit qëndrojnë në grupet në të cilat kanë punuar në aktivitetin e mëparshëm. Ata marrin fletë në të cilat shkruhen fjalët e mëposhtme: fjalë, fotografi, video, tingull (në më shumë kopje) dhe fotografi në të cilat paraqiten mjete të ndryshme mediatike/teknike, të tilla si: radio pranues, TV, kompjuter, telefon celular, shtypshkronjë, etj. Nxënësit duhet të shoqërojnë fjalët me fotografi nga mediumi/pajisja përkatëse.



Reflektim

- Çfarë mësuam në orën e sotme?
- A mund ta aplikojmë këtë njohuri në jetën e përditshme? Si?



Ora 2

Ngjashmëritë dhe dallimet midis mediave tradicionale dhe digjitale

Standardi për vlerësim

Nxënësi/nxënësja:

- ↘ i përshkruan ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet mediave tradicionale dhe mediave digjitale.

Burimet për orën mësimore:

- ↘ qasje në internet;
- ↘ tabelë inteligjente/tabelë e zakonshme;
- ↘ markerë;
- ↘ karta me ilustrime;
- ↘ fletë letre.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Punë për minutë (realizimi 5 minuta)

Për një minutë, nxënësit, të ndarë në grupe, shkruajnë tre fjalë që tregojnë një shpjegim ose veçori të termit *tradicional* dhe gjithashtu për një minutë nga tre fjalë për fjalën *digjitale*. Pastaj, secili grup thotë fjalët, ndërsa mësimdhënësi rregullon dhe shkruan shpjegimet që nxënësit japin në tabelë. Përmes diskutimit të shkurtër arrihet në shpjegimin e termave në kontekste të ndryshme, ndërsa vëmendja përqendrohet në kuptimin e tyre në lidhje me mediat.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Mediat tradicionale dhe digjitale (realizimi 20 minuta)

Mësimdhënësi, duke u bazuar në shpjegimet e fjalëve *tradicionale* dhe *digjitale*, u kërkon nxënësve të përipiqen të bëjnë një ndarje të mediave në tradicionale dhe digjitale. Nxënësit, të ndarë në grupe, marrin fletë pune ku janë shënuar media të ndryshme si televizioni, gazetat, radio, revista, Snapchat, Twitter, portalet elektronike, Massinger, Facebook, SMS, YouTube, Instagram, TikTok, Viber. Detyra e grupeve është vendosja e mediave të listuara në dy kategori: media tradicionale dhe digjitale. Pastaj, një nxënës nga grupi paraqet ndarjen që ata kanë bënë në grup.

Pas prezantimit, mësimdhënësi bën pyetjet e mëposhtme:

- ↘ Çfarë është e përbashkët për mediat që janë të grupuara në një kategori dhe çfarë është e zakonshme për ato në grupin tjetër?
- ↘ Për se dallohen dy kategoritë e mediave?
- ↘ Çfarë kanë të përbashkët të gjitha mediat e mësipërme?
- ↘ Si të kërkojmë informacione në ndonjë nga mediat e përmendura?
- ↘ Si na vijnë informacionet nga media të ndryshme?

- ↳ Në cilat media përdoruesit kanë mundësi të komentojnë ose të reagojnë menjëherë?
- ↳ Në cilat media përdoruesi ka mundësi të krijojë dhe publikojë informacionin e vet?

Pas përgjigjes së pyetjeve dhe mendimeve dhe përgjigjeve të ndryshme të mundshme për këto pyetje, nxënësit, me ndihmën e mësimitdhënësit, arrijnë në përfundimin se të gjitha mediat janë kanale komunikimi përmes të cilave transmetohen informacione dhe/ose mesazhe. Megjithatë, dallimi është se përmes mediave tradicionale (në formë të shtypur ose elektronike) mesazhet transmetohen në mënyrë të njëanshme, nga një dërgues në më shumë marrës, ndërsa përmes mediave digjitale transmetimi zhvillohet në shumë drejtime – nga një në më shumë përdorues ose nga të gjithë në të gjithë. Por, ekziston mundësia që marrësi i mesazheve të reagojë ndaj përmbajtjes, përkatësisht, në të njëjtën kohë mund të jetë edhe krijues dhe dërgues i përmbajtjeve.

Nxënësit konkludojnë se mediat digjitale janë ato media që përdorin teknologjinë kompjuterike dhe internetin për të përgatitur dhe transmetuar përmbajtje. Sot, mediat tradicionale përshtaten me mjedisin digjital dhe shprehinë e përdoruesve, të cilat gjithnjë e më shumë po informohen përmes pajisjeve digjitale. Kështu, media digjitale përfshin mediat e internetit, video-lojërat, rrjetet sociale, filmat që përdorin animacione 3D, tekste dhe fotografi që lindin nga përdorimi i kompjuterëve, duke përfshirë përmbajtje për mësim, tekste në formë digjitale dhe shumë përmbajtje të tjera.


Pjesa e fundit e orës mësimore

1 Aktiviteti


Karakteristikat e mediave (realizimi 5 minuta)

Nxënësit me ndihmën e mësimitdhënësve e prezantojnë atë që anë mësuar në *diagramin e Venit* të cilin mësimitdhënësi e vizaton në tabelë. Nxënësit me ngritjen e dorës tregojnë nga një karakteristikë të mediave tradicionale ose digjitale, të gjitha karakteristikat e përbashkëta dhe të njëjta të mediave tradicionale dhe digjitale vihen në pjesën e përbashkët, ndërsa dallimet shkruhen në anë të ndryshme.

Diagrami i Venit



Një shembull i disa prej fjalëve/termave që mund të jenë pjesë e diagramit të Venit:



1 Shtojca

	Lloji i përmbajtjeve mediatike	Koha e shpenzuar duke parë përmbajtje mediatike	Në çfarë lloj media ndiqet përmbajtja mediatike
	Çfarë dëgjoja/shikoja?	Sa kohë kam dëgjoja/shikoja? (nga - deri më)	Ku shikoja/dëgjoja?
E hënë			
E martë			
E mërkurë			
E enjte			
E premte			
E shtunë			
E diel			
Shënim			



Reflektim


- Çfarë mësuam në orën e sotme?
- A i përdorni më shumë mediat tradicionale ose digjitale për të marrë informacionin që kërkonti? Pse?
- Si mund ta përdorim atë që kemi mësuar në jetën tonë të përditshme?



Detyrë shtëpie

Nxënësve u jepet detyrë shtëpie të plotësojnë tabelë në të cilën duhet të shënojnë mediat dhe përmbajtjen që ata ndjekin gjatë javës, si dhe kohën e kaluar në ndjekjen e përmbajtjeve. (Shtojca 1)


(Detyrat e shtëpisë janë përgatitje për realizimin e orës së ardhshme mësimore për edukim mediatik).



MEDIAT

SOCIALE

(3 orë)



Ora 1

Përparësitë dhe mangësitë e përdorimit të internetit gjatë kërkimit

Standardi për vlerësim

Nxënësi/nxënësja:

- shpjegon përparësitë dhe mangësitë e përdorimit të internetit gjatë kërkimit të përmbajtjeve.

Burimet për orën mësimore:

- fletë pune me tabela;
- qasje në internet;
- tabelë inteligjente/projektor LCD;
- filmi i animuar "Aventurë përmes edukimit mediatic";
- fletë letre/ngjitëse;
- markerë.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Mediat si pjesë e jetës së përditshme (realizimi 5 minuta)

Nxënësit e ndarë në grupe analizojnë tabelat që kanë plotësuar si një detyrë shtëpie, kush dhe çfarë përmbajtje kanë ndjekur, sa kohë kanë kaluar duke ndjekur ato përmbajtje gjatë ditës dhe në cilat media. Pastaj, secili grup paraqet të dhënat që kanë shënuar nxënësit. Mësuesi inkurajon grupet të tregojnë se sa kohë kanë përdorur internetin, cilat përmbajtje kanë kërkuar/ndjekur përmes shfletuesve të internetit dhe cilat pajisje kanë përdorur.

Nxënësit dhe mësmdhënësi bëjnë analiza dhe arrijnë në përfundim për mënyrën në të cilën nxënësit ndjekin dhe përdorin përmbajtjen mediatike. Së bashku arrijnë në përfundimin se ata kalojnë një pjesë të kohës së tyre duke ndjekur përmbajtje mediatike (pak/shumë/mjaftueshëm), duke theksuar ato përmbajtje që ndjekin më shpesh, si dhe pajisjet që përdorin për këtë qëllim (laptop, kompjuter, telefon).

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Shikimi i një filmi të shkurtër (realizimi 25 minuta)

Nxënësit shohin një film të shkurtër të animuar "Aventurë përmes edukimit mediatic"⁵

- Çfarë përmbajtje mund të gjendet në internet?
- Cilat informacione të dobishme mund të kërkohen dhe të gjenden në internet?
- Si e bën interneti jetën tonë më të lehtë?
- A mendoni se ka rreziqe dhe kurthe kur kërkoni për përmbajtje në internet?
- Cilat janë ato?

⁵ ASHMAA (2016) "Aventurë nëpërmjet edukimit mediatic"; një film i animuar i përkthyer dhe i përshtatur i prodhuar nga EAVI. Në dispozicion në: <https://www.youtube.com/watch?v=TdcUk-xgBX8>.

Nëse nxënësit nuk japin përgjigje konkrete, mësuesi i ndihmon të kuptojnë simbolikën oqeanit, ishullit të lirisë, krijesave nënujore, piratëve, si dhe varkës dhe rolin e Svetle-s në filmin e specifikuar.

Pas diskutimit dhe shpjegimit të filmit, nxënësit, të ndarë në grupe, në fletë shkruajnë nga tre përvoja pozitive dhe tre negative gjatë kërkimit të përmbajtjeve në internet. Fletët ngjiten në tabelë. Mësuesi i përdor shënimet e nxënësve për të hapur një diskutim nga i cili duhet të konkludohet se interneti, nga njëra anë, ofron shumë mundësi për informim, komunikim, mësim dhe argëtim, por nga ana tjetër, përmes internetit transmetohet edhe shumë informacione dhe përmbajtje që mund të jenë të pavërteta, të dëmshme dhe të rrezikshme për përdoruesit.

Pjesa e fundit e orës mësimore

1 Aktiviteti

Rekomandime për përdorimin e internetit (realizimi 10 minuta)

Nxënësit punojnë në grupe të vogla. Kanë për detyrë të shkruajnë tre fjali në formën e mesazheve në lidhje me përdorimin e internetit, sipas asaj që kanë mësuar gjatë orës. Mësuesi u jep disa shembuj: *“Kur kërkoni, jo të gjitha dritaret duhet të hapen, veçanërisht ato që shkëlqejnë ose kanë simbole të pakuptueshme”* ose *“Duhet të hapim vetëm ato faqe që mendojmë se janë të sigurta”*.

Pastaj, i analizojnë dhe krahasojnë mesazhet në grupe të vogla, ndërsa në fund secili grup lexon mesazhet para nxënësve të klasës.



Reflektim

- Çfarë mësuam në orën e sotme?
- Si mund ta përdorim atë që kemi mësuar në jetën tonë të përditshme?

Ora 2

Përparësitë dhe mangësitë e mediave sociale

Standardi për vlerësim

Nxënësi/nxënësja:

- i shpjegon përparësitë dhe mangësitë e mediave sociale.

Burimet për orën mësimore:

- fletë pune;
- ngjitës;
- tabelë inteligjente/tabelë e zakonshme;
- markerë.

Pjesa hyrëse e orës mësimore


1 Aktiviteti

Rrethi im (realizimi 10 minuta)

Mësuesi i jep udhëzime secilit nxënës në fletën e punës "Rrethi im" (Shtojca 1) të shkruajë vendet ku ai shkon, emrat e miqve me të cilët ai është në kontakt të vazhdueshëm dhe me të cilët shoqërohet – në sport ose aktivitete të tjera, ndërsa ndjek një hobi ose shoqërohet me fëmijët e lagjes. Pastaj, nxënësit në çiftet paraqesin atë që kanë shkruar.

Mësuesi e drejton aktivitetin kah përfundimi se ne takohemi me shumë njerëz në baza ditore – miq, të afërm, fqinjë, etj. Duke i përgatitur për aktivitetin e ardhshëm, i fton nxënësit të mendojnë se sa njerëz takojnë në internet, përkatësisht përmes rrjeteve sociale.

1 Shtojca 1 – Rrethi im



Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Rrjetet sociale (realizimi 25 minuta)

Mësuesi tregon etiketat/logot të mediave të ndryshme sociale (për shembull: Viber, Facebook, Instagram, TikTok, Snapchat), nxënësit identifikojnë rrjetet sociale dhe tregojnë se cilat i përdorin dhe për çfarë qëllimi (për shembull për komunikim, informim, argëtim, edukim).

2 Shtojca

Mediat sociale	E përdor për



Mësuesi bën pyetje:

- Në cilën pjesë të ditës i përdorni mediat sociale (në një pjesë të caktuar të ditës, kur nuk jam në shkollë, gjatë gjithë kohës...)?
- A kanë platformat e mediave sociale që përdorni rregulla për *anëtarësim* në lidhje me moshën?
- Çfarë duhet të bëni nëse ka *kufizim* për moshë?
- A duhet t' i informoni prindërit tuaj se i përdorni rrjetet sociale?

Pastaj nxënësit, të ndarë në grupe, marrin një fletë pune (Shtojca 3) për krahasim midis komunikimit përmes mediave sociale me komunikim të drejtpërdrejtë, sipas kriterëve të mëposhtme:

3 Shtojca 3 ➤ Fleta e punës ➤ Llojet e ndryshme të komunikimit

Llojet e ndryshme të komunikimit	Komunikim i drejtpërdrejtë	Nëpërmjet mediave sociale
<i>krijimi dhe mirëmbajtja e kontakteve</i>		
<i>prezantimi i aftësive dhe mundësive personale</i>		
<i>shprehja e ndjenjave të vërteta</i>		
<i>shfaqja e një imazhi të rremë të vetes</i>		
<i>disponueshmëria e informacioneve</i>		
<i>vërtetësia e informacioneve</i>		
<i>qëllime dhe aktivitete edukative</i>		

Krahasimin e bëjnë duke shkruar se cili është avantazhi i secilit prej dy llojeve të komunikimit në lidhje me secilin nga kriteret e listuara dhe nga çfarë konsiston ai avantazh shembull: “Mediat sociale lejojnë krijimin e më shumë kontakteve dhe mirëmbajtjen e përditshme të kontakteve me miq në lokacione të ndryshme, ndërsa kontaktet që krijohen dhe mbahen përmes komunikimit të drejtpërdrejtë janë më të afërta/të drejtpërdrejta”). Gjatë krahasimit, nxënësit marrin parasysh atë që kanë punuar edhe në aktivitetin “Rrethi im” në orën e sotme. Grupet prezantojnë punën e tyre. Në fund, bëhet përmbledhje se komunikimi përmes rrjeteve sociale ka shumë përparësi, por që nuk mund të zëvendësojë komunikimin live.

Pjesa e fundit e orës mësimore


1 Aktiviteti

Përparësitë dhe mangësitë e mediave sociale (realizimi 5 minuta)

Nxënësit në mënyrë të pavarur shënojnë nga një përparësi dhe nga një mangësi të mediave sociale sipas pikëpamjeve të tyre dhe në përputhje me diskutimet në orën mësimore.

Reflektim

- Çfarë mësuam?
- Si mund ta përdorim atë që kemi mësuar në jetën tonë të përditshme?



Ora 3

Mediat sociale - siguria e mediave sociale

Standardi për vlerësim

Nxënësi/nxënësja:

- i shpjegon përparësitë dhe mangësitë e mediave sociale.

Burimet për orën mësimore:

- tabelë inteligjente/tabelë e zakonshme;
- markerë;
- fletë letre;
- qasje në internet;
- film.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Siguria personale në mediat sociale (realizimi 10 minuta)

Mësimdhënësi shpjegon se si duhet të krijohet harta mendore.⁶ Pastaj ai propozon titullin e hartës mendore që duhet ta bëjnë nxënësit – “Siguria personale në mediat sociale”. Nxënësit, të ndarë në grupe, shkruajnë një term kyç fillestar dhe pastaj “e ndajnë” dhe bëjnë lidhje midis termave që thonë (media sociale, siguria, të dhënat personale, ndërveprimi, sjellja e papërshtatshme e anëtarëve të tjerë të rrjetit, përmbajtje të papërshtatshme, reklama, etj.). Pasi grupet të kenë bërë hartat mendore, një përfaqësues nga secili grup paraqet hartën para të gjithë klasës.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Pyetja

Kush jam unë? (realizimi 25 minuta)

Nxënësit në një copë letër shkruajnë disa detaje për veten e tyre, pa specifikuar emrin, mbiemrin, adresën, datën e lindjes dhe të ngjashme. Çdo nxënës duhet të prezantohen me ndihmën e shenjave, simboleve, prerjeve nga revista, të cilat do të jenë një pikë referimi për të, dhe me disa deklarata të shkurtra, të tilla si: e pëlqej futbollin, kam sy të zinj, frutat e mia të preferuara janë luleshtrydhet, etj. Mësuesi mbledh fletët, i përzien dhe i vendos në një vend. Një fletë bosh është vendosur pranë çdo fletë të shkruar. Pastaj, një nxënës lexon me rend “përshkrimet”, nxënësit e tjerë “qëllojnë” se kush është prapa përshkrimit ndërsa një nxënës shkruan në fletë emrin e nxënësit “i cili njihet”.

Pas leximit të të gjitha fletëve, kalojmë në “leximin e dytë”, ku pas leximit të përshkrimit, paraqitet nxënësi që e ka shkruar. Nxënësi që merr shënime kontrollon për të parë nëse, sipas përshkrimit të dhënë, nxënësit e tjerë kanë qëlluar “autorin” e tekstit.

Nxënësit diskutojnë nëse ishte e lehtë të qëllohej se përshkrimi/prezantimi i kujt ishte, çfarë informacioni ndihmoi në qëllimin, çfarë informacioni ishte i panevojshëm dhe në veçanti tërhiqet vëmendja për pyetjet e mëposhtme:

- Cilat të dhëna do të donit ose nuk doni të ndani për veten tuaj? Cila është arsyeja për këtë?

⁶ Kjo teknikë mundëson sublimimin dhe dhënien e “pasqyrës së përgjithshme për temën” dhe në të njëjtën kohë siguron kuptim të koncepteve dhe marrëdhënieve midis tyre.

- ↘ A do të ndiheshit mirë të ndanit të dhënat tuaja personale me njerëz që nuk i njihni?
- ↘ A ndjeheni të sigurt kur i ndani të dhënat tuaja?
- ↘ A duhet të ndahen të dhënat personale me persona të panjohur?
- ↘ A duhet të kërkojnë miratimin e prindërve/kujdestarëve për të ndarë të dhënat personale?

Mësuesi më pas lëshon një film të shkurtër “*Një udhëtim në edukimin mediatik: privatësia dhe gjurmimi*”, pas së cilës zhvillohet një diskutim mbi sigurinë e secilit individ në mediat sociale dhe arrihet në përfundimin se dhënia e të dhënave personale është konfidenciale dhe duhet të bëhet vetëm nëse dihet se kujt dhe pse i jepet informacioni, përkatësisht të dhënat personale.

Pjesa e fundit e orës mësimore

1 Aktiviteti

Ndarja e informacionit/të dhënave personale (realizimi 5 minuta)

Nxënësit paraqiten me ngritjen e dorës nëse duhet të ndajnë përvojën e tyre për ndarjen e të dhënave personale. Mësuesi i “udhëzon” me pyetjet: Vallë dhe nga kush u janë bërë pyetje t’i jepni të dhënat tuaja (në rrjetet sociale, online lojërat, etj.)? A mendoni se kjo është e rrezikshme dhe pse?




Reflektim

- Çfarë mësuam?
- Si mund ta përdorim atë që kemi mësuar në jetën tonë të përditshme?

7 ASHMAA (2016). “Udhëtimi në edukimin mediatik: Privatësia dhe ndjekja”, film i përkthyer dhe i përshtatur i prodhuar nga EAVI. Në dispozicion në: https://www.youtube.com/watch?v=U_VY6zjPoQA

FAKTE DHE OPINIONE

(6 orë)



Ora 1

Dallimet midis fakteve dhe opinioneve

Standardi për vlerësim

Nxënësi/nxënësj:

- ↘ bën dallimin ndërmjet përcjelljes së fakteve dhe shprehjes së një qëndrimi/opinionit personal në përmbajtje mediatike.

Burimet për orën mësimore:

- ↘ tabelë inteligjente dhe/ose tabelë;
- ↘ qasje në internet;
- ↘ fletë pune;
- ↘ shënues me ngjyrë;
- ↘ flomasterë.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

E vërtetë ose jo (realizimi 10 minuta)

Nxënësit, të ndarë në çifte, marrin nga një fletë pune me dhjetëra fjali/deklarata që duhet të tregojnë nëse ato janë fakte ose opinione, sipas asaj nëse janë të verifikueshme (nëse ato mund të dëshmohen se janë të vërteta apo jo), nëse janë të njëjta (të pandryshueshme) ose të ndryshueshme me kalimin e kohës.

Shembuj të fakteve:

E hëna është dita e parë e javës.

Njerëzit kanë nevojë për ushqim, për të jetuar.

Më 2 gusht, festohet lindenit.

Shembuj të opinionëve:

Jam në humor të keq të hënën.

Të shkosh në plazh është më argëtuese se të shkosh në mal.

Akullorja më e mirë është akullorja me shije çokollatë.

Pastaj, një çift lexon faktet, ndërsa të tjerët kontrollojnë për të parë nëse i kanë shënuar të njëjtat fjali si fakte. Në fund, mësuesi jep përgjigjen e saktë. Një çift tjetër lexon opinionet, të tjerët kontrollojnë, dhe me ndihmën e mësuesit, përcaktohen përgjigjet e sakta.

Është arritur në përfundimin se faktet mund të verifikohen dhe të vërtetohen se janë të vërteta dhe të paanshme. Opinione, nga ana tjetër, pasqyrojnë pikëpamjet dhe bindjet për gjëra të caktuara dhe për këtë arsye janë subjektive dhe të njëanshme.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Fakt ose opinion (realizimi 20 minuta)

Mësuesi citon shembuj, ndërsa nxënësit përcaktojnë nëse bëhet fjalë për fakt apo opinion, në mënyrë që të kuptojnë dallimet themelore midis këtyre nocioneve.

Mësimdhënësi jep shembullin e mëposhtëm: *“Për mendimin tim, Spanja është vendi më i mirë për pushime”*. Nxënësit më pas tregojnë nëse pajtohen apo jo me atë që është thënë dhe diskutojnë nëse kjo deklaratë është e saktë/e verifikueshme.

Konkludohet se deklaratat përcjell një mendim, besim ose pikëpamje. Mundet, por nuk është e thënë të bazohet në fakte dhe nuk mund të vërtetohet se vetë opinioni është i drejtë apo i gabuar.

Pastaj, mësuesi jep shembuj të tjerë: *“Macja është gjitar. Mali më i lartë në Maqedoninë e Veriut është Korabi i Madh me 2,753 metra”*. Nxënësit, bazuar në njohuritë e tyre dhe diskutimin e mëparshëm, përcaktojnë saktësinë/vërtetësinë e deklaratave.

Konkludohet se faktet mund të verifikohen dhe vërtetohen se janë të vërteta ose të pasakta.

Në vazhdim të orës mësimore, nxënësit marrin fletë që përmbajnë disa fakte dhe opinione që duhet të shënohen me një ngjyrë të përkatëse (me të verdhë ato deklaratat që përfaqësojnë opinione, dhe me ngjyrë të gjelbër ato të cilat nxënësit i konsiderojnë si fakte). Mësuesi ka përgatitur diapozitiv (slajde) me deklaratat nga fletët e punës (Shtojca 1) dhe diapozitiv me përgjigjet e sakta nga fletët e punës (Shtojca 2).

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur, ndërsa pas përfundimit të detyrës, mësuesi u tregon atyre diapozitivin me përgjigjet. Secili nxënës kontrollon nëse është përgjigjur saktë, dhe pastaj së bashku diskutojnë dallimet midis fakteve dhe opinioneve. Mësimdhënësi moderon diskutimin duke bërë pyetje:

- Si përcaktuat se çfarë është fakt?
- Si përcaktuat se çfarë është opinion?
- Çfarë ishte e vështirë për ju në këtë ushtrim?

Pjesa e fundit e orës mësimore

1 Aktiviteti

Le të ngjyrosim (realizimi 10 minuta)

Nxënësit punojnë në çifte dhe në tekstin e dhënë shënojnë çfarë është opinion dhe çfarë është fakt. (opinionet i shënojnë me të verdhë dhe faktet me flomaster të gjelbër)

Fakte interesante në lidhje me zogun kolibri

Kolibri (shk. Trochilidae) janë një familje e shpendëve që i përkasin llojit çiopi (Apodiformes). Sipas shumë njerëzve, kolibrat janë zogjtë më të bukur në botë. Familja e zogut kolibri ka më shumë se 100 lloje dhe midis 330-340 specie.

*Kolibri janë zogj shumë të vegjël. Kolibrat më të vegjël, të cilët janë edhe speciet më të vogla të shpendëve në përgjithësi, *Mellisuga helenae*, së bashku me sqepin dhe pendët e bishtit janë vetëm gjashtë centimetra të gjatë. Nëse më pyesni mua, unë pa hezitim do ta deklaroj këtë specie si më të bukurën në botë.*

Ata pastaj shqyrtojnë dhe krahasojnë përgjigjet në grupe të vogla, dhe në fund secili grup ndan përgjigjet para nxënësve nga e gjithë klasa dhe së bashku kontrollojnë saktësinë e përgjigjeve.

32



Reflektim

- Çfarë mësuam?
- Si mund t' i dallojmë faktet nga opinionet?
- Si mund ta përdorim atë që kemi mësuar në jetën tonë të përditshme?



1 Shtojca 1 ➤ Dallimi i fakteve nga opinionet

• Shembull 1

Galiçica është mal në rajonin e Ohrit-Prepës.

• Shembulli 2

Galiçica është mali më i bukur në Maqedoni.

• Shembulli 3

Galiçica është 2,254 metra e lartë dhe nga maja e saj mund të shihni dy liqenet më të mëdhenj natyrorë në Maqedoni: Liqenin Ohrit dhe Liqenin e Prepës.

• Shembulli 4

Qeni është miku më i mirë i njeriut.

• Shembulli 5

Lufta e Dytë Botërore u zhvillua midis viteve 1939 dhe 1945.

2 Shtojca 2 ➤ Dallimi i fakteve nga opinionet ➤ përgjigjet e sakta

• Shembull 1

Galiçica është mal në rajonin e Ohrit-Prepës. / fakt

• Shembulli 2

Galiçica është mali më i bukur në Maqedoni. / opinion

• Shembulli 3

Galiçica është 2,254 metra e lartë dhe nga maja e saj mund të shihni dy liqenet më të mëdhenj natyrorë në Maqedoni: Liqenin Ohrit dhe Liqenin e Prepës. / fakt

• Shembulli 4

Qeni është miku më i mirë i njeriut. / opinion

• Shembulli 5

Lufta e Dytë Botërore u zhvillua midis viteve 1939 dhe 1945. / fakt

Ora mësimore 2

Këndi i historisë

Standardet e vlerësimit

Nxënësi/nxënësja:

- ↘ krijon lajm të shkurtër në lidhje me një ngjarje;
- ↘ krijon përmbajtje mediatike përmes së cilës përcillen fakte/opinionet.

Burimet për orën mësimore:

- ↘ fletë pune;
- ↘ ilustrime;
- ↘ përralla e Kësulëkuqes.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Vizatimi sipas udhëzimeve të dhëna (10 minuta)

Nxënësit ndahen në çifte dhe ulen të kthyer me shpinë njëri nga tjetri. Njëri nxënës në çift ka një vizatim para tij, në të cilin ka disa ilustrime (për shembull, një kamion, një shtëpi, një urë...). Ai duhet t'i shpjegojë partnerit të tij se çfarë të vizatojë, por duke dhënë udhëzime, dhe jo duke treguar drejtpërdrejt temën e vizatimit (për shembull, vizato dy rrrathë të lidhur me një vijë, vizato një katror mbi ta, le të ketë dy rrrathë të tjerë përpara, etj.). Ai që dëgjon mund të bëjë pyetje, por nuk duhet të pyesë se për cilin send/temë bëhet fjalë. Kur të gjithë do të vizatojnë atë që u ka thënë partneri i tyre, duhet të kthehen dhe të shikojnë fotografimin origjinal.

Pastaj mësuesi i pyet nxënësit: A ka dallim mes origjinalit dhe vizatimit? Nga vijnë këto dallime? Çfarë mendoni se është më e lehtë, të pranosh apo të ndash informacione? Pse? A mund ta shprehim me fjalë atë që mendojmë apo atë që shohim? A mund ta kuptojmë saktësisht se çfarë mendon personi që po na tregon diçka? A do t'i ndihmonte mirëkuptimi midis njerëzve për të përshkruar më shumë gjërat që ata mendojnë ose duan të thonë?

Konkludohet se dallimet midis origjinalit dhe vizatimit në aktivitet janë për shkak të një shpjegimi jo mjaft të saktë dhe të qartë, por edhe për shkak të subjektivitetit të interpretimit të asaj që i thuhet dëgjuesit.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Historia e Kësulëkuqes nga një kënd tjetër (realizimi 25 minuta)

Nxënësit ulen në një rreth dhe mësuesi njofton se do të lexojë historinë e Kësulëkuqes të treguar nga ujku.

Kësulëkuqja dhe ujku

Një ditë u ndjeva shumë i uritur. Isha duke ecur në pyll dhe me të vërtetë, po me të vërtetë përpiqesha të gjej diçka për të ngrënë. Ju nuk e dini se çfarë do të thotë të jesh vetëm dhe i uritur. Isha edhe i vetmuar. Shikoja lulet e thara me kokën poshtë, dëgët e zbrazëta të pemëve, kosheret e zbrazëta të bletëve. Ishte vjeshtë e thatë, e verdhë, e zbrazët, e uritur dhe e mërzitshme. Dhe, krejt papritmas, e shoh Kësulëkuqen me një shportë kaataaq të madhe me byrek dhe plot gjëra të tjera në të. E nuhata nga hyrja e pyllit. Diçka po më trokiste në fyt. Ja preva rrugën dhe menjëherë pa turp – uria nuk nje turp – i kërkova të më qerasë byrek. Ajo, e veshur e rregulluar, më tha se byreku nuk ishte pjekur për mua, se duhej të gjeja vetë atë që kërkova, jo gjithçka të kem të gatshme. Kësulëkuqja u largua, ndërsa unë fillova të qaj, isha shumë i uritur. Papritmas më erdhi një ide jetë-shpëtuese: të shkoja te gjyshja! E zgjodha rrugën e shkurtër dhe arrita shumë shpejt. Gjyshja, njësoj si Kësulëkuqja, mezi më lejon të hyj, nuk më dha asgjë për të ngrënë. Pashë, nuk pashë, fillova të ulërit. Ajo doli nga dera me pantofla. U veshu me disa rrobat e saj dhe prita që të vinte Kësulëkuqja. Më në fund erdhi. Hesht, përgjigjem vetëm shkurt: po, jo. Ajo më dha një pjatë plot me byrek. Oh, çfarë feste.



Pas leximit, nxënësit, të ndarë në grupe, u përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:

- Çfarë menduat/si e përjetuat Kësulëkuqen para se të dëgjoni historinë e ujkut?
- Çfarë menduat për ujkun?
- Çfarë mendon për Kësulëkuqen tani, po për ujkun?
- A ka ndryshuar mendimi juaj për ujkun që kur e dëgjuat këtë version të përrallës? Pse?
- A ka të drejtë ujku?
- A ka ndonjë argument për t' i besuar atij?
- A është versioni i tij më pak i mundshëm se ai që kishit dëgjuar më parë?
- Ku është e vërteta: në njërin nga versionet ose në versionin e ri, të unifikuar?

Pas përgjigjes së pyetjeve, hapet diskutim nëse për të marrë një pamje korrekte dhe realiste të gjërave dhe ngjarjeve, është e nevojshme të keni sa më shumë informacione dhe informacione sa më të sakta rreth ngjarjeve. Nëse në ndonjë lajm apo informacion, është përfshirë vetëm një mendim, kjo paraqet vetëm një pjesë e realitetit?

Në fund, konkludohet se për të nxjerrë përfundimin e duhur për dikë ose diçka, është e nevojshme të shikohet situata përmes "syve" të palës tjetër. Nëse duam të informohemi plotësisht dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse për një ngjarje, duhet të kërkojmë, lexojmë dhe dëgjojmë versione të ndryshme të ngjarjes, domethënë të marrim informacione nga disa persona dhe burime të ndryshme.

Pjesa e fundit e orës mësimore

1 Aktiviteti

Ana tjetër e historisë (realizimi 5 minuta)


Mësuesi inkurajon nxënësit, në grupe, të ndajnë ndonjë situatë/informacion që kanë parë/dëgjuar në media (televizion, radio, gazeta, media elektronike, rrjete sociale), që ka bërë të ndryshojnë mendjen pas “dëgjimit të palës tjetër”, përkatësisht “historisë tjetër” për të njëjtën situatë.

Pastaj, një përfaqësues nga grupi para të gjithë nxënësve nga klasa ndan një situatë/informacion për të cilën janë pajtuar se është më interesantja nga të gjitha situatat që janë diskutuar në grup.



Reflektim

- Çfarë mësuam?
- Si mund ta përdorim atë që kemi mësuar në jetën tonë të përditshme?



Ora 3

Çfarë është lajm?

Standardet e vlerësimit

Nxënësi/nxënësja:

- krijon lajm të shkurtër në lidhje me një ngjarje;
- krijon përmbajtje mediatike përmes së cilës përcillen fakte/opinionet.

Burimet për orën mësimore:

- tabelë inteligjente dhe/ose tabelë;
- markerë;
- fletë letre;
- qasje në internet;
- Tekste të përgatitura paraprakisht me lloje të ndryshme lajmesh.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Fjalë e panjohur (realizimi 15 minuta)

Nxënësit, të ndarë në grupe, marrin tekst nga mësuesi me detyrë ta lexojnë dhe t'i ndajnë fjalët e panjohura (tekstet mund të jenë nga revistat e fëmijëve ose revistat e tjera, por të kuptueshme dhe të përshtatshme për moshën e nxënësve).

Në këtë aktivitet jepen si shembull tekstet e mëposhtme:

Manifestime letrare për fëmijë (teksti për grupin e parë)

Më shumë se 200 vepra letrare mbërritën në konkurset letrare të shpallura në kuadër të manifestimit letrar "Takime nën panje – Vidoe Podgorec". Nxënësit e shkollës fillore shkruanin në dy tema: "Çfarë është vesa" dhe "Edhe kur gënjej, them të vërtetën". Konkursat janë frymëzuar nga vepra e poetit vendas dhe një nga autorët më të frytshëm maqedonas për fëmijët Vidoe Podgorec.

Konkurset humoristike, ndërkohë, janë në nder të autorit Kiro Donev, mikut dhe bashkëpunëtorit më të ngushtë të Podgorec dhe themeluesit të manifestimit.

Manifestimi letrar për fëmijë "Takime nën panje – Vidoe Podgorec" u mbajt për herë të 21-të në Strumicë dhe në Koleshino. Aktivitetet dyditore filluan në Strumicë, me këshilla të ekspertëve për bibliotekarët, me temën "Bibliotekat janë themeli i shkrim-leximit".

Pjesa e fundit e manifestimit u mbajt në shkollën "Vidoe Podgorec" në Koleshino. Përveç ndarjes së çmimeve për veprat më të suksesshme, morën pjesë rreth 150 nxënës nga disa shkolla fillore nga vendi, të cilët me performancat e tyre i dhanë një ndikim të veçantë "Takimet nën panje" të këtij viti.⁸

Kampi veror për futbolliste të reja në Dojran të Ri (teksti për grupin e dytë)

Në periudhën nga 16 deri më 20 maj, në Dojran, u mbajt një kamp veror për futbolliste të reja të lindura në vitin 2008, 2009 dhe 2010. Në kamp morën pjesë 37 vajza të talentuara nga e gjithë Maqedonia, të cilat janë futbolliste aktive në klubet e tyre.

⁸ Nova Makedonija, seksioni "Kolibri" (2022) "Takimet nën panje – Vidoe Podgorec 2022". Në dispozicion në: <https://www.novamakedonija.com.mk/prilozhi/kolibri/sredbi-pod-javorite-vidoe-podgorec-2022/>.

Siç na informon një nga trajnerët Bojana Tanova, këto futbolliste të reja stërviten dy herë në ditë, ndërkaq bëhet fjalë për përzgjedhjen e futbollisteve të reja për reprezentacionin kombëtar U-15. Sipas Tanovës, ato stërviten me përkushtim dhe seriozisht edhe pse janë të reja i dëgjojnë këshillat e trajnerëve të tyre. Tanova gjithashtu theksoi se, përveç që janë adhurese për futbollit, të gjitha janë nxënëse të shkëlqyera.

Qëllimi i këtij projekti është edukimi dhe përzgjedhja e vajzave të reja që e duan futbollin. Dy trajnime mbahen çdo ditë ndërsa trajnerë dhe profesorë të licencuar të edukatës fizike punojnë me futbollistet e reja: Katerina Milevska, Bojana Tanova, Dragi Atanasovski, Stankica Atanasova dhe Jovica Bllazhevski.

Koordinator i këtij projekti, i cili ka filluar që nga viti 2019, është Dobri Dimovski, ish-trajner i ekipit kombëtar të femrave të Maqedonisë.⁹

Pas leximit të teksteve dhe shpjegimit të fjalëve të panjohura (nëse ka), nga një përfaqësues i grupit lexon tekstin me zë të lartë para të gjithë klasës.

Mësuesi bisedon me nxënësit për informacionet që merret nga të dy tekstet. Ai u bën atyre pyetjet e mëposhtme: Si quhet teksti i shkurtër që jep informacione? Pse shkruhen (ose incizohen) lajme? Çfarë informacioni ka në të parën, dhe çfarë informacioni ka në të dytën?

Pastaj u jep detyrë nxënësve, në grupe, të veçojnë informacionet e rëndësishme dhe të përpiqen të bëjnë pyetje në lidhje me informacionet e dhëna në tekst.

Një përfaqësues nga secili grup lexon informacionet e ndara dhe pyetjet nga të cilat mund të merren informacione.

Në fund, me ndihmën e mësuesit, konkludohet se lajmi është një formë e shkurtër e informimit dhe ofron informacion për diçka që ka ndodhur. Lajmi duhet të përmbajë përgjigjet e pyetjeve të mëposhtme: Çfarë (ka ndodhur)? Kush (ka marrë pjesë/ kush ka bërë)? Ku (ka ndodhur)? Kur (ka ndodhur)? dhe Pse (ka ndodhur)?

⁹ Nova Makedonija, seksioni "Kolibri" (2022) "Kampi veror për futbollistët e rinj në Nov Dojran". Në dispozicion në: <https://www.novamakedonija.com.mk/prilozi/kolibri/leten-kamp-za-mladi-fudbalerki-vo-nov-dojran/>

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Pesë pyetje në të cilat duhet të përgjigjet lajmi (realizimi 20 minuta)

Mësuesi u kërkon nxënësve të përpilojnë lajm nga pjesët e ofruara (fjalë dhe fjali). Gjatë përpilimit të lajmit, duhet të udhëhiqen nga pesë pyetjet: Çfarë? Kush? Ku? Kur? dhe Pse?

Nxënësit, të ndarë në grupe, marrin një fletë pune me pjesë të lajmit që duhet të përpilojnë dhe një listë me pyetje nga të cilat duhet të udhëhiqen gjatë përpilimit të lajmit.

Fletë pune

- golat u shënuan nga Omeragiq, Stojanovski dhe Berant
- rezultat 3:1
- revansh- ndeshje
- ekipi i futbollit Çair
- ekipi i futbollit Tetovë
- fitorja e parë e mysafirëve
- në stadiumin "Slloga" më 12.5.2022 (e shtunë)
në orën 17.00

ÇFARË (ka ndodhur)?

KUSH (ishte i përfshirë)?

KU (ka ndodhur ngjarja)?

KUR (ka ndodhur – koha dhe data?)

PSE ka ndodhur - shkaqe?)

Pas 15 minuta punë në grup, një nxënës nga secili grup lexon tekstin që kanë shkruar. Teksti i përpiluar mund të duket kështu:

Gjatë revansh ndeshjes të zhvilluar më 12.5.2022 në orën 17.00 në stadiumin "Slloga", ekipi i futbollit "Çair" mposhti ekipin "Tetova" me rezultat 3:1. Ishte fitorja e parë e mikpritësit ndërsa golat u shënuan nga Omeragiq, Stojanovski dhe Berant.

Pjesa e fundit e orës mësimore

1 Aktiviteti

Çfarë është lajmi? (realizimi 5 minuta)



Në pjesën e fundit të orës mësimore, në grupe, nxënësit u përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:

- Cila ishte pjesa më e vështirë dhe cila ishte pjesa më e lehtë gjatë shkrimit të lajmit?
- Në cilat pyetje duhet të përgjigjet lajmi?
- Cilat janë disa nga karakteristikat kryesore të lajmit?
- Çfarë lajme shihni/lexoni në media? Për cilën temë?

Në fund, secili grup përgjigjet para të gjithë nxënësve në paralele dhe së bashku kontrollojnë saktësinë e tyre.

40



Reflektim

- Çfarë mësuam në orën e sotme?
- Ku mund të lexojmë/dëgjojmë/shohim lajme?
- Pse duhet të dimë çfarë janë lajmet dhe si krijohen?
- A e dini se kush zakonisht shkruan lajme në media?



Detyrë shtëpie

Informim ditor

Nxënësit, të ndarë në çifte, zgjedhin një ngjarje interesante që ka ndodhur në shkollë ose në vendin e tyre të banimit. Detyra e tyre është të shkruajnë lajm rreth ngjarjes duke përdorur fakte – për të treguar se çfarë ndodhi, kush mori pjesë, si, ku dhe kur ndodhi ngjarja. Një nga nxënësit, në rolin e një gazetari, lexon tekstin e shkruar, dhe një tjetër e incizon me telefon celular. Incizimet e të gjitha grupeve prezantohen në orën e ardhshme për edukim mediatik dhe vlerësohen bashkërisht për sa i përket faktit nëse janë të përfaqësuara të gjitha elementet e kërkuara për përshkrimin e ngjarjes (çfarë, kush, ku, kur dhe pse).

Detyrat e shtëpisë duhet të kryhen brenda një jave.

Ora 4

Dunëtori "Redaksi" (2 orë)

Standardet e vlerësimit

Nxënësi/nxënësj:

- krijon lajm të shkurtër në lidhje me një ngjarje;
- krijon përmbajtje mediatike përmes së cilës përcillen fakte ose/dhe opinione.
- krijon pyetje të thjeshta për të kryer një intervistë.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Pyetje dhe përgjigje (realizimi 5 minuta)

Në fillim, nxënësit i paraqesin incizimet që kanë përgatitur dhe analizojnë së bashku nëse janë të përfaqësuar të gjitha elementet e kërkuara për përshkrimin e ngjarjes (çfarë, kush, ku, kur dhe pse). Mësuesi më pas i inkurajon nxënësit t' i përgjigjen disa prej pyetjeve të mëposhtme: Çfarë është lajm? Ku e keni dëgjuar/parë prezantimin e lajmit/eve? Si quhen njerëzit që shkruajnë lajme/transmetojnë informacione? Ku punojnë ata? A keni dëgjuar për termin "redaksi"?

Nxënësit vullnetarisht i përgjigjen pyetjes që e dinë, ndërsa mësuesi plotëson secilën përgjigje me të dhënat e nevojshme për t' u mundësuar nxënësve të fitojnë njohuri themelore për përmbajtjen.

Në fund, së bashku ata bëjnë një përmbledhje se redaksia në një media të caktuar përbëhet nga gazetarë dhe redaktorë. Në varësi të mediumit, redaksia ka ekipet e veta sipas fushave: kulturë, sport, çështje politike, arsim dhe të ngjashme.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Krijojmë përmbajtje mediatike (realizimi 30 minuta)

Nxënësit japin propozime për përgatitjen e përmbajtjeve mediatike që do të jenë objektive dhe të bazuara në fakte (për shembull: jetë e shëndetshme, ekologji, etj.). Nxënësit ndahen në grupe (secili grup përfaqëson një "redaksi" në një medium të veçantë) dhe duhet të përpunojnë dhe përgatisin përmbajtje të caktuara për temën e zgjedhur. Brenda grupit (përkatësisht redaksisë), nxënësit marrin rolin e gazetarit, fotografit, redaktorit dhe kryeredaktorit. Pastaj, në përputhje me rolin në redaksi, secili merr një detyrë të caktuar:

- gazetarët duhet të mbledhin informacion mbi këtë temë dhe të shkruajnë lajm;
- fotografi duhet të bëjë një fotografi përkatëse që do të shoqërojë lajmin, ose të zgjedhë një fotografi nga Interneti;
- redaktori duhet të lexojë lajmin dhe të vendosë se ku do ta publikojë,

përkatësisht ku do ta prezantojë (në ueb faqen e shkollës, në tabelën për shpallje në shkollë, do të ndahet përmes Viber grupit të klasës, etj.) në varësi të publikut për të cilin është dedikuar;

- ↳ kryeredaktori duhet të mbikëqyrë të gjithë procesin e krijimit dhe prezantimit të lajmit.

Nxënësit bëjnë një plan pune (nëse dhe kë duhet të pyesin/intervistojnë, ku duhet të hulumtojnë/ të mbledhin informacion, si të paraqesin informacionet, të përcaktojnë një afat kohor për shkrimin e lajmit/përmbajtjes mediatike, për fotografinë, kur duhet t'ia paraqesin tekstin redaktorit dhe kryeredaktorit).

Nxënësit gjithashtu marrin udhëzim se në procesin e informimit, nuk duhet të publikohen informacione të pa verifikuara.

Shembull i temave dhe udhëzime për përgatitjen e lajmit /përmbajtjes mediatike:

Ekologji

- Nxënësit, të ndarë në grupe, krijojnë një tekst mediatik, qëllimi i të cilit është të informojë nxënësit më të vegjël dhe t'u shpjegojë pse nuk duhen përdorur qese plastike dhe enë plastike për të ngrënë dhe pirë. Detyra e tyre është të përdorin fakte dhe opinione bindëse të ekspertëve për dëmin nga përdorimi i objekteve plastike për planetin Tokë. Ata mund të kërkojnë informacione në internet ose nga media të tjera. Tekstet e shkruara u lexohen nxënësve më të vegjël gjatë orës së mësimit ose kombinohen në një broshurë që u shpërndahet atyre.

Stil jetese i shëndetshëm

- Nxënësit përpilojnë nga 3 pyetje për intervistë për të marrë një mendim nga psikologu ose pedagogu i shkollës se si nxënësit mund të zhvillojnë shprehi të shëndetshme të jetesës. Grupet lexojnë pyetjet dhe në një diskutim të përbashkët përzgjedhin pesë ose gjashtë pyetje të cilat do t'i parashtrojnë gjatë intervistës së vërtetë. Gjatë intervistës, një nxënës bën pyetjet, një tjetër shkruan përgjigjet dhe nxënësi i tretë incizon me telefon celular. Intervista publikohet në ueb faqen e shkollës në formë të shkruar dhe/ose të incizuar.

Pjesa e fundit e orës mësimore

1 Aktiviteti

Shpërndarja e detyrave në redaksi (realizimi 5 minuta)

Secili grup (redaksi) paraqet planin dhe detyrat e secilit anëtar të redaksisë (kush çfarë duhet të përgatisë deri orën e ardhshme) para klasës dhe marrin informacion kthyes / reagime nga mësuesi dhe shokët e klasës.



Reflektim

- Çfarë mësuam në orën e sotme?
- Pse duhet të dimë se si punon redaksia në një media?
- Kush është përgjegjës për përmbajtjen e publikuar (gazetari, fotoreporteri, redaktori apo të gjithë së bashku)?



Ora 5

Punëtori "Redaksi"

Standardet e vlerësimit

Nxënësi/nxënësja:

- ↳ krijon lajm të shkurtër në lidhje me një ngjarje;
- ↳ krijon përmbajtje mediatike përmes së cilës përcillen fakte ose/dhe opinione.
- ↳ krijon pyetje të thjeshta për të kryer një intervistë.

44



Reflektim

- Çfarë mësuam në orën e sotme?
- Pse është i rëndësishëm profesioni i gazetarit?
- Pse është me rëndësi të dimë se si punon redaksia në një media?

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Nga informacioni deri te lajmi i redaktuar (realizimi 20 minuta)

Nxënësit nëpër grupe shkëmbejnë të dhënat e mbledhura në përputhje me rolin që kanë pasur (të dhëna nga hulumtimi, intervista, deklaratat, fotografi) dhe formojnë versionin përfundimtar të përmbajtjes mediatike. Pasi redaktori miraton përmbajtjen për publikim, atë ia dorëzojnë kryeredaktorit.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Publikimi i lajmit (realizimi 20 minuta)

Nxënësit nga secili grup i publikojnë veçmas përmbajtjet mediatike në një medium të caktuar ose i prezantojnë para shokëve të tyre të klasës. Një grup mund të ndajë përmbajtje përmes një aplikacioni specifik në telefonat celularë, përmes ueb faqes të klasës/shkollës, si mesazhe për prindërit/komunitetin lokal, ose përmes posterave/vizatimeve në tabelën e shpalljeve.

Të gjithë nxënësit dëgjojnë/lexojnë/shikojnë përmbajtjet mediatike dhe japin komentet e tyre.

Pjesa e fundit e orës mësimore

1 Aktiviteti

Pyetje dhe përgjigje (realizimi 5 minuta)

Nxënësit në grup, u përgjigjen pyetjeve: A mendoni se keni përcjellë me sukses lajmin/përmbajtjen mediatike tek audiencia? Vallë bazohet në fakte përmbajtja? A keni përfshirë ndonjë mendim në përmbajtje? A është interesant profesion gazetar?

Në fund të orës, një përfaqësues nga secili grup tregon shkurtimisht nëse ata si grup janë të kënaqur me punën e bërë dhe me cilat sfida u përballën gjatë punës.

Ora 6

Verifikimi i besueshmërisë së përmbajtjeve mediatike

Standardi për vlerësim

Nxënësi/nxënësjë:

- përdorni mënyra të thjeshta për të verifikuar besueshmërinë e përmbajtjeve mediatike në internet.

Burimet për orën mësimore:

- fletë pune;
- tabelë inteligjente;
- qasje në internet;
- set fotografish;
- markerë.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Fotografi (realizimi 5 minuta)

Nxënësit së bashku analizojnë setin e fotografive (Shtojca 1). Mësuesi së pari paraqet një diapozitiv në të cilin është një fotografi, dhe pastaj një diapozitiv që tregon fotografinë e vërtetë, përkatësisht shpjegimin se si është bërë fotografia e parë.

1 Shtojca





Burimi: Faqja e internetit "Crno belo"¹⁰

Nxënësit japin mendimet e tyre se si është bërë fotografia, nëse kanë pasur përvojë në bërjen e një fotografie të tillë dhe si.

Në fund, konkludohet se ka aplikacione të ndryshme që mund të modifikojnë ose shfaqin gjërat e fotografuara ndryshe, prandaj, gjithmonë duhet të tregohet kujdes dhe, për aq sa është e mundur, duhet të kontrollohet besueshmëria e fotografisë.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Lajme të rreme (realizimi 25 minuta)

Mësuesi përgatit informacione të rreme nën titullin "Gorilla arratiset nga kopshti zoologjik i Nju Jorkut". Në tekst thuhet se kur kafsha është arratisur, theksohet rreziku nga një gorillë e lirë dhe paralajmërohen njerëzit të mos dilnin nga shtëpia. Nuk përmendet Nju Jorku, as burimi i lajmit. Teksti shoqërohet me fotografinë e një gorille që ecën nëpër rrugët e ndonjë qyteti. Lajmin, së bashku me fotografinë, ua shpërndan nxënësvë. Nxënësit ndahen në grupe të vogla dhe u jepet detyra të kontrollojnë vërtetësinë e lajmit dhe besueshmërinë e fotografisë. Për këtë qëllim, kërkojnë në internet – shkruajnë "një gorillë u arratis nga një kopsht zoologjik në

¹⁰ Online portal argëtues "Crno belo" Në dispozicion në: <https://www.crnobelo.com/zabava/interesno/60904-14-foto-dokazi-deka-sovrshenite-instagram-fotki-se-lazhni>

Nju Jork” dhe zbulojnë se nuk ka publikim për lajm të tilla nga burime relevante. Nxënësit për të verifikuar fotografinë përdorin faqen <https://images.google.com/>. Mësuesi u jep atyre udhëzimet e mëposhtme për verifikimin e besueshmërisë së informacionit:

- ↘ në internet kërkoni publikimin origjinal;
- ↘ kontrolloni datën e publikimit;
- ↘ kontrolloni nëse autori është nënshkruar;
- ↘ kontrolloni nëse në ueb faqen ka një seksion të veçantë RRETH NESH / KONTAKT / IMPRESUM (kush është pronari, redaktori, kush janë gazetarët, etj.);
- ↘ kontrolloni burimet e informacionit (nëse ato përmenden);
- ↘ kontrolloni nëse fotografia lidhet me përmbajtjen apo jo;
- ↘ kontrolloni cilësinë e tekstit për sa i përket standardit gazetaresk, nëse artikulli bazohet në burime përkatëse, nëse është i paanshëm, objektiv, etj.;
- ↘ kontrolloni shfletuesin që përdorni më shpesh (Google, Bing...) ose në ndonjë agregator lajmesh (time.mk, network, mk, fox.al..) nëse ka media të tjera lokale, rajonale ose media ndërkombëtare që raportojnë për këtë temë;
- ↘ nëse lajmi rezulton të jetë jo i besueshëm, pasi të keni kontrolluar të gjitha hapat e mëparshëm, kontrolloni nëse ndonjë nga rrjetet sociale (Facebook, Twitter) ose verifikuesit lokalë të fakteve (proverkanafakti.mk, crithink.mk) e kanë shënuar këtë artikull si jo të besueshëm;
- ↘ krahasoni informacionet në këtë artikull me postime të tjera dhe krahasoni tekstet për të parë nëse përputhen.

Së bashku konstatohet se lajmi është i rrejshëm, ndërsa fotografia nuk është e besueshme. Përmes diskutimit konkludohet se është shumë lehtë (veçanërisht përmes mediave sociale) të shpërndahen informacione të rreme dhe të shpërndahen fotografi të rreme ose të ndryshuara.

Pjesa e fundit e orës mësimore

1 Aktiviteti

Besueshmëria e një fotografie (realizimi 10 minuta)

Nxënësit diskutojnë për besueshmërinë e fotografive që çdo ditë i shohin ose ndajnë në internet/rrjetet sociale, si dhe për rrezikun e ekspozimit ndaj fotografive të rreme dhe lajmeve që janë të besueshme për shkak të përpunimit të tyre teknik.

Nga diskutimi, me ndihmën e mësuesit, konkludohet se sa herë që nxënësit vërejnë diçka të pazakontë, ata duhet të kontrollojnë informacionin ose fotografitë përmes burimeve të shumta, sepse edhe ata me më shumë përvojë dhe njohuri mediatike ndonjëherë bëjnë një gabim në leximin/njohjen e informacionit.



Reflektim

- Çfarë mësuam sot?
- Si mund ta përdorim atë që kemi mësuar në jetën tonë të përditshme?
- A mund ta përdorim këtë që mësuam në jetën reale apo në internet?
- Pse është e rëndësishme të dimë se si të verifikojmë informacionet?



